



Nr. 20 /12

Datë: 13.09.2012

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 1,2,3 dhe 4, nenit 5 nënparagrafi 1.1 dhe nenit 49 nënparagrafi 1.1 dhe 1.5 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i Agjencisë mori këtë:

V E N D I M

1. Urdhërohet Besëlidhja/Zavet Mikrofinance-BZMF të eliminoj te gjitha parregullsitë e bëra në raportet individuale të transaksioneve kreditore të këtyre kredive; numri identifikues i kredisë; [REDACTED].
2. Këshillohet kontrolluesi Besëlidhja/Zavet Mikrofinance-BZMF që të shikoj të gjitha dosjet nga 01.05.2010 gjerë më 12.09.2012 për të eliminuar të gjitha parregullsitë e mundshme .
3. Të njoftohet Agjencia brenda 30 ditëve lidhur me zbatimin e vendimit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

Arsyetim

Në bazë të ankesës së subjektit [REDACTED] lidhur me keqpërdorimin e të dhënave personale nga kontrolluesi Besëlidhja/Zavet Mikrofinance (në tekstin e mëtejme BZMF), zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror ka inspektuar dhe kontrolluar përpunimin e të dhënave personale nga ana e kontrolluesit BZMF. Me ç' rast ka konstatuar se kontrolluesi BZMF ka bërë përpunim të kundërligjshëm të të dhënave personale me rastin e deklarimit të të dhënave në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme BQK) në tri raportet individuale të transaksioneve kreditore (në tekstin e mëtejme RITK) me numër identifikues të kredisë; [REDACTED].

BZMF në Regjistrin e Kredive të Kosovës të BQK-së ka prezantuar të dhënat në RITK me numër identifikues të kredisë; [REDACTED] si garantues [REDACTED] me numër identifikues personal [REDACTED]. Numri identifikues personal dhe të gjitha të dhënat e tjera të prezantuara në RITK janë të pasakta, ngase garantues në këto dy hua-kredi është [REDACTED] me numër identifikues personal [REDACTED]. BZMF ka bërë përpunim të kundërligjshëm të të dhënave personale duke ndërruar emrin nga [REDACTED] në [REDACTED]. Ndërrimi i emrit nga ana e BZMF-së është ne kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 3 paragrafët 1,2,3

dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku specifikohet që të dhënat personal përpunohen në mënyrë të ligjshme, të sakta dhe të përditësuara. Ndërrimi i emrit nga ana e BZMF-së është bërë në kundërshtim me të gjitha ligjet në fuqi, dhe të dhënat personale të prezantuar në RITK nuk janë të sakta dhe adekuate.

BZMF në Regjistrin e Kredive të Kosovës të BQK-së, ka prezantuar të dhënat në RITK me numër identifikues i kredisë; [REDAKTUAR]; si garantues [REDAKTUAR] me këto të dhëna: me numër identifikues personal [REDAKTUAR], me datë të lindjes 10.10.1988, me numër të telefonit [REDAKTUAR]. Këto të dhëna janë të dhëna personale të [REDAKTUAR] të prezantuara në RITK me numër identifikues të kredisë [REDAKTUAR]. Në këtë rast, përpos që kemi ndërrim dhe prezantim të jashtëligjshëm të të dhënave personale, [REDAKTUAR] nuk është fare garantues në hua-kreditë me numër [REDAKTUAR]. BZMF me prezantimin e të dhënave të [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 3 paragrafi 3 dhe 4, nenit 5 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ku precizohet se të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe mund të përpunohen vetëm për qëllime të caktuara të qarta dhe legjitime me pëlqimin e subjektit, në rastin në fjalë të dhënat janë përpunuar më tutje në mënyrë të kundërligjshëm pa pëlqimin e subjektit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] duke e prezantuar si garantues në hua-kreditë [REDAKTUAR]. Gjithashtu të dhënat personale janë përpunuar në mënyrë të kundërligjshëm me qëllimin e parë të mbledhur, me ç'rast të dhënat e [REDAKTUAR] për hua-kreditë e tjera janë ndryshuar dhe prezantuar në hua-kreditë [REDAKTUAR].


BZMF ka bërë përpunimin të kundërligjshëm të të dhënave personale në raportet e prezantuara në Regjistrin e Kredive të Kosovës të BQK-së, në të tri rastet ku ka ndërruar emrin e personit nga [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR]. Gjersa në një rast prezanton si garantues [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] në hua-kredi marrje ku fare nuk është garantues.

Për shkak se gjatë shqyrtimit të vetëm një ankese të një subjekti kemi konstatuar tri përpunime të kundërligjshme të të dhënave personale, është e domosdoshme që BZMF të bëjë rishikimin e të gjitha dosjeve të hua-kredive për të evituar përpunimin e kundërligjshëm të të dhënave personale të subjekteve të cilët kane marrë apo aplikuar për hua-kreditë në këtë institucion mikrofinanciar, qoftë si hua-kredimarrës, bashkë hua-kredimarrës apo si garantues.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror


Mentor Hoxhaj

Vendimi i dërgohet:

- Besëlidhja/Zavet Mikrofinance - BZMF
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë

